



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2020:006272

Datë: 16.07.2024

Numri i dokumentit: 05945791

C.nr.592/2019

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditësit K.M nga fshati Radostë, Komuna e Rahovecit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati R.H nga Rahoveci, ndaj të paditurës S me seli në Prishtinë, për shkak të objektit të kontestit – kompensim dëmi, jashtë seancës, më datën 16.07.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET e tërhequr padia e paditësit K.M nga fshati Radostë, Komuna e Rahovecit, ndaj të paditurës S me seli në Prishtinë, në çështjen juridike kontestimore, C.nr.592/2019.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi K.M nga fshati Radostë, Komuna e Rahovecit, në këtë gjykatë më datën 19.12.2019, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar ka parashtruar padinë ndaj të paditurës S, për shkak të objektit të kontestit – kompensim dëmi.

Me aktvendimin e datës 26.06.2020, kjo gjykatë i ka obliguar të paditurit që të paraqesin përgjigje në padi, të cilët cili brenda afatit ligjor edhe kanë paraqitur përgjigjen e tyre në padi.

Me parashtrësën e datës 02.07.2024, përfaqësuesi i autorizuar i paditëses e ka njoftuar gjykatën se e tërheqë padinë, të cilën parashtrësë kjo gjykatë i ka dorëzuar të paditurës dhe përkundër faktit se ka kaluar afati 7 ditor nga dita e pranimit të kësaj parashtrëse, e njëjta nuk është përgjigjur në lidhje me këtë parashtrësë.

Prandaj, meqenëse të paditurës i është dërguar parashtrësja e paditëses për tërheqjen e padisë dhe e paditura brenda afatit 7 ditor nuk e ka kundërshtuar tërheqjen e padisë, kjo gjykatë vlerëson se janë plotësuar kushtet ligjore që padia e paditësit të konstatohet e tërhequr. Kështu, në nenin 261.2 të LPK-së parashihet që *“Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë.”*

Vendimi mbi shpenzimet procedurale, që secila palë t'i bartë këto shpenzime, është marrë në kuptim të nenit 450 të LPK-së pasi që secila palë paraprakisht vet i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta.

Prandaj, nga ajo që u tha më lartë, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e në bazë të nenit 261.2, 261.3 dhe 261.4 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.592/2019, më datën 16.07.2024

Gjyqtari
Berkan Hamza

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.